



Planuar / Dorezuar Prilbjen/Prodato Received/Delivery		20.05.2022		2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
Sigurnisht	2948/2022		1/5		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova -- Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.279/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.279/2022 të datës 23.03.2022 të parashtruar nga ankuesi [ ] në cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [ ]

me adresë rruga [ ] kundër Vendimit me 07/4Nr. Prot:935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.279/2022 të datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesi [ ]

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr 07/4Nr.Prot:935 i datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

**A r s y e t i m**

Ankuesi [ ] i punësuar në Agjencisë e Zhvillimit të Bujqësisë, përmes përfaqësuesit të tij, fizikisht më datë 23.03.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1556/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me 07/4Nr.Prot.935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me pretendimet për shkelje ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë



05.04.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa Këshilli, më datë 13.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. Prot: 1556/2022 e datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr. Prot:5538 i datës 30.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Emailin e datës 23.03.2022, 30.08.2021, 21.03.2022; Vendimin me 07/4Nr. Prot:935 të datës 28.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Vendimin me Nr. Prot:4998 i datës 21.07.2021 për pezullim nga puna i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; Aktvendimin PPS.nr.47/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special; Autorizimin e datës 21.03.2022; Akt Emërimit e datës 12.01.2017 në emër të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 13.04.2022; Emailin e datës 25.02.2022 nga \_\_\_\_\_ Emailin e datës 24.02.2022 nga \_\_\_\_\_ Emailin e datës 25.01.2022 nga \_\_\_\_\_ Shkresën për shqyrtimin e kërkesës me Nr. Prot:5483 e datës 23.08.2021; Emailin e datës 23.08.2021 nga \_\_\_\_\_ Njoftim i datës 15.07.2021 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Emailin e datës 20.08.2021 nga \_\_\_\_\_ Procesverbalin e datës 30.08.2021 me Nr. Prot:5535 i Komisionit Disiplinor; Emailin nga \_\_\_\_\_ lidhur me opinionin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, **SEPSE**:

Nga administrimit i provave materiale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me Nr. Prot:45 të datës 12.01.2017 është i punësuar në pozitën Inspektor në Regjionin e Prishtinë në kuadër të Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë. Më datë 15.07.2021 Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural se janë arrestuar të pandehurit (mesin e tyre edhe ankuesi) për vepra penal dhe ndaj tyre është caktuar masa e paraburgimit.

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë përmes Vendimit me Nr. prot:4998 të datës 21.07.2021 ka bërë pezullimin nga puna të ankueses me 50% të pagës deri në marrjen e një vendimi tjetër. Më datë 23.08.2021 rasti i ankuesit është inicuar në Komisionin Disiplinor. Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 30.08.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:5538 me të cilin ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare deri në një vendim tjetër, si dhe do të kompensohet me 50% të pagës.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 25.01.2022 ka kërkuar opinion ligjor nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me interpretimin e nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në muajin Shkurt të 2022 ka lëshuar opinion ligjor duke sqaruar se: "bazuar

*në nenin 58 paragrafi 4 pezullimi për 6 muaj nga komisioni disiplinor është pezullim me pagesë prej 50% të pagës, ndërsa pas kalimi të afatit prej 6 muajsh, nuk mund të bëhet më pagesë, kjo e drejtë është rezervuar në nenin 58 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06.L-114 për Zyrtarët Publikë”.*

Bazuar në shkresat e lëndës, Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë bazuar në opinionin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 28.02.2022 ka nxjerr Vendim 07/4 Nr.Prot:935 me të cilin ka bërë plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr. Port:5538 të datës 30.08.2021, duke bërë ndërprerjen e kompensimit në vlerën prej 50% të pagës së plotë për ankuesin.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Vendimi me Nr.Prot:4998 i datës 21.07.2021 i Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për pezullim nga puna të ankuesit është nxjerr në kundërshtim me nenin 56 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe pa pasur kompetencë; Vendimi Nr. Prot:5538 i datës 30.08.2021 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë është nxjerr jashtë afatit prej 30 ditësh nga data e inicimit të procedurës disiplinore ndërsa Vendimi me 07/4Nr. Prot:935 të datës 28.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Fillimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket Vendimit me Nr. Prot:4998 të datës 21.07.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për pezullim nga puna dhe Vendimit Nr. Prot:5538 të datës 30.08.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, konstaton se nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi kundër këtyre vendimeve ka parashtruar ankesë brenda afateve të përcaktuara me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, si rrjedhojë nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve sa i përket kësaj çështje që lidhet me pezullim nga puna.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 48 paragrafi 5, ka përcaktuar që: *“Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të çenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”,* ndërsa neni 56 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka paraparë pezullimin sipas detyrës zyrtare nga organi përkatës i punëdhënësit, konkretisht paragrafët nga 1. 1 deri në 1.9 ka përcaktuar rastet e këtij pezullimi si: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e parashikuara në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, qeveri të luaj apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi; 1.5. deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës; 1.6. regjistrohet, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet qendrore e lokale, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit; 1.7. nëse ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, që deklarohet nga vetë nëpunësi,

sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij në një pozite tjetër, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji; 1.8. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimit për nevojat e institucionit për periudhën që ndjek këtë program me shkëputje nga puna; 1.9. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj.

Bazuar në këto dispozita si dhe ndërlidhur me dispozitat e nenit 58 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se meqenëse Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me Vendimin me Nr. Proto:5538 të datës 30.08.2021 ka bërë pezullimin nga marrëdhënia e punës së ankuesit me 50% të pagës, mirëpo meqenëse kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj nga koha e pezullimit, atëherë Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin të Bujqësisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me 07/4Nr. Prot:935 të datës 28.02.2022 me të cilin i ndërprehet kompensimi në vlerën 50% të pagesë për ankuesen, duke vepruar mbi bazë të opinionit ligjor të MPB-së, si organ që në bazë të nenit 11 pika 1.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka kompetencë të mbështet dhe këshilloj institucionet për zbatim të këtij ligji, ndërsa kolegji nuk është lëshuar në ligjshmëri të këtij opinionit për faktin se sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë sa i përket efektit të pezullimit është i qartë për faktin se në çdo situatë juridike pas kalimit të periudhës prej 6 muajve nëpunësi civil nuk mund të përfitoj pagë dhe mbi bazë të kësaj dispozite Komisioni Disiplinor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me Vendimin Nr 07/4Nr.Prot:935 të datës 28.02.2022 ka vepruar në pajtim me deponatat e nenit 58 paragrafi 4 ndërlidhur me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të këtij ligji, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.279/2022, datë 18/05/2022

Avdyt BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë; dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së.

